



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



E K S T R A K T I I P R O C E S V E R B A L I T

**të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më
06.05.2015, e cila filloi në orën 15:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, shef i GP të LDK-së, Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së, Besa Rafuna përfaqësuese e LDK-së, Hatixhe Hoxha, përfaqësuese e LVV-së, Imer Rusinovci, shef i GP të AAK-së, Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, Laura Zherka, përfaqësuese e PDK-së dhe Islam Pacolli, shef i GP të AKR-së.

Munguan: Qëndron Kastrati, shef i GP të LVV-së dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP.

Morën pjesë edhe: Agim Salihu, këshilltar i kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, Rabit Krasniqi, përfaqësuesi nga OSBE-ja, Valentina Abazi dhe Emine Haliti përfaqësuese nga INPO-ja.

Mbledhjen e kryesoi dhe e udhëhoqi **Halim Halimi**, kryesues i Komitetit.

Para se të fillonin diskutimet rreth pikave të rendit të ditës, **Lirak Çelaj**, paraqiti qëndrimin e PDK-së, që pikat të cilat kanë të bëjnë me Drejtorinë e Urbanizmit, të mos diskutohen dhe të mos votohen. Bazuar në këtë, ai propozoi që pikat e rendit të ditës (sipas rendit të ditës të propozuar), pika e dytë - Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për caktimin e lokacionit për ngritjen e përmendores së Ismail Qemalit; pika e tretë - Propozimvendimi për ndryshimin - përshtatjen e profilit të rrugës së planifikuar "F-F" në mes të blloqeve "B 1" dhe "B 2" të Planit rregullues "Lakërishta" dhe, pika e katërt - Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Mati 1", të hiqen nga rendi i ditës.

Sami Hamiti u shpreh në përkrahje të propozimit të z. Çelaj.

Lirak Çelaj kërkoi sqarim lidhur me rolin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi theksoi se KPF-ja është Komitet i përhershëm, obligativ. Sipas nenit 52.2 të LVL-së, thuhet se KPF është përgjegjëse për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë

dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal etj. **Lirak Çelaj** kërkoi sqarime se kush e cakton datën e mbledhjeve dhe rendin e ditës.

Kryesuesi dha sqarime rreth datës së mbledhjeve dhe rendit të ditës.

Sami Hamiti tha se ka qenë praktikë e përcaktuar me vite, që data e mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit të jetë e enjtja e fundit e atij muaji.

Ai sugjeroi që anëtarët e Kuvendit të pyeten për rendin e ditës dhe datën e mbajtjes së mbledhjes.

Kryesuesi kërkoi nga Shërbimi i Kuvendit, që thirrja për mbledhjen e KPF të bazohet edhe në Rregulloren për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës.

Kryesuesi e hodhi në votim heqjen e pikave 2, 3 dhe 4 nga rendi i ditës.

Kryesuesi konstatoi se me pesë(5) vota për: Sami Hamiti, shef i GP të LDK-së, Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së, Besa Rafuna përfaqësuese e LDK-së, Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, Laura Zherka përfaqësuese e PDK-së, dhe tri (3) vota kundër: Imer Rusinovci, shef i GP të AAK-së, Hatixhe Hoxha, përfaqësuese e LVV-së dhe Halim Halimi, kryesues i Komitetit, u miratua propozimi që pikat 2, 3 dhe 4 të hiqen nga rendi i ditës.

U konstatua se u miratua ky

REND DITE:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë;**
- 2. Shqyrtimi i raportit financiar tremujor, për periudhën janar-mars 2015;**
- 3. Informatë për sigurinë në komunë, me theks të veçantë siguria në shkolla;**
- 4. Informatë për funksionimin e transportit lokal;**
- 5. Informatë për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e varrezave;**
- 6. Të ndryshme.**

Pika e parë

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Shqyrtimi i raportit financiar tremujor, për periudhën janar-mars 2015.

Dardan Sejdiu theksoi se raporti financiar tremujor është obligim ligjor, dhe për këtë pikë do të informojë Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës.

Visar Berisha dha sqarime lidhur me raportin financiar tremujor, për periudhën janar-mars 2015. Ai theksoi se Komuna e Prishtinës ka arkëtuar gjithsej 3,853,965.40 €.

Informoi për pasqyrën e arkëtimit të të hyrave vetanake, pasqyrën e planifikimit vjetor dhe realizimit të të hyrave vetanake për periudhën janar – mars 2015, pasqyrën e shpenzimeve për periudhën janar-mars 2015 dhe pasqyra e investimeve dhe detyrimeve.

Sami Hamiti tha se është obligim ligjor të diskutohet buxheti në Komitetin për Politikë dhe Financa. Pjesa numerike dhe pasqyrat janë reale dhe tregojnë gjendjen reale se trendët janë të ulët. Arkëtimi nga të hyrat nuk është i kënaqshëm dhe arsye kryesore për arkëtim të ulët është Vendimi i Qeverisë për faljen e borxheve. Te pjesa e projekteve, duhet të përmirësohet raporti dhe, si përfundim, mund të thuhet se këtij raporti nuk i jepet notë pozitive.

Hatixhe Hoxha përkrahu dërgimin e raportit në Kuvend.

Lirak Çelaj u pajtua që të shkojë kjo pikë.

Imer Rusinovci e përkrahu këtë pikë.

Laura Zherka propozoi që të shtohet një tabelë shtesë dhe të ceket data kur është bërë projekti dhe emri i kompanisë që e ka fituar atë projekt.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Raporti tremujor, për periudhën janar-mars 2015, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tretë

Informatë për sigurinë në komunë, me theks të veçantë siguria në shkolla.

Kryesuesi theksoi se materialin e kemi, por nuk ka ardhur askush nga Drejtoria e Arsimit që të informojë lidhur me këtë pikë, e që është dashur të vijë.

Laura Zherka u shpreh se për pikat e rendit të ditës duhet me qenë dikush nga ajo drejtoria përkatëse, për të na dhënë informacionet e nevojshme.

Dardan Sejdiu theksoi se tash e tutje në secilën mbledhje, do të jetë drejtori ose përfaqësuesit i drejtorive përkatëse për pikat që iu takojnë të referojnë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Informata për sigurinë në komunë, me theks të veçantë siguria në shkolla, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e katërt

Informatë për funksionimin e transportit lokal.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Informata për funksionimin e transportit lokal dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e pestë

Informatë për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e varrezave.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Dardan Sejdiu**. Ai tha se mirëmbajtjen e hapësirave në varreza e kryen ndërmarrja “Hortikultura”. Një nga planifikimet për këtë vit është edhe vendosja e rrethojave në varrezat e fshatit Barilevë.

Lirak Çelaj tha se për varrezat e besimeve të tjera, si p.sh. për protestantët, pse nuk është ndarë ndonjë lokacion. Duhet të ruhen disa vlera, sepse janë të barabartë, andaj është mirë të ndahet një lokacion për varrezat e tjera. Njëherësh kërkoi edhe rishikimin e pozitës së varrezave të qytetit.

Islam Pacolli tha se në emër të fshatit Hajvali është bërë një kërkesë për një lokacion për varreza. Ai kërkoi edhe rregullimin e varrezave të Hajvalisë.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Informata për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e varrezave dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e gjashtë

Të ndryshme

Lirak Çelaj tha se kemi informacione se punëtorët e kuzhinave të çerdheve nuk janë paguar tash e disa muaj.

Dardan Sejdiu dha sqarime lidhur me këtë. Ai tha se është kryer pagesa për punëtorët e kuzhinave në çerdhe.

Islam Pacolli kërkoi qasje në dokumentacionin (kontratën) e rrugës nga rruga kryesore për Graçanicë deri te QMF – ja në Hajvali (aktualisht është duke u punuar në këtë rrugë, mirëpo nuk po punohet në bazë të projektit).

Sami Hamiti theksoi se për çështjen e kontratës duhet konsultuar Zyrën e Prokurimit.

Lirak Çelaj shprehu shqetësimin e banorëve të lagjes “Velania” për rregullimin e rrugës në Velani, ku kompania e ujësjellësit regjional “Prishtina” ka vendosur gypin kryesor dhe rruga ka mbetur pa u rregulluar, andaj qytetarët kërkojnë që të shtrohet rruga në tërësi, nëse shpreh gatishmëri (të ndërmjetësojë në këtë punë) Komuna. Ujësjellësi regjional “Prishtina”, ka thënë që do ta shtrojë vetëm atë pjesë të rrugës që e ka dëmtuar, por nëse Komuna do t’iu ofroj mjete, ata do ta shtrojnë të gjithë rrugën.

Dardan Sejdiu tha se është përgjegjësi e ujësjellësit regjional “Prishtina”, ata e kanë në kontratë që ta sjellin në gjendjen e mëparshme rrugën. Deri tash Kryetari iu ka drejtuar ujësjellësit regjional “Prishtina” me pesë shkresa, përgjigja ka qene se do të kryhet shpejt kjo rrugë.

Islam Pacolli pyeti se si të veprohet për çështjen e diskutimit të rrugës në Hajvali, të vendoset si pikë e rendit të ditës, apo në - Të ndryshme.

Dardan Sejdiu tha që t’i bëhet shkresë Zyrës së Prokurimit .

Mbledhja përfundoi në orën 16:20.

Procesmbajtës:
Zijadin Gashi
Shyhere Islami

Kryesuesi i Komitetit
Halim Halimi, jur.i dipl.